



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 32 prot.

Kamëz, më 11. 3.2022

V E N D I M

Nr. 28 Datë 11 / 3 2022

MBI

“ MIRATIMIN E PLANIT TE MBROJTJES CIVILE DHE DOKUMENTIT PËR  
VLERËSIMIN E RRISKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE “.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **11.03.2022** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.25 Datë 9.03.2022** në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji, Nr. 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile, Ligji nr. 103/2014 “ Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë ”, VKM nr.747, datë 20.11.2019 “ Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ”, Ligji nr. 97/2019 “ Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit,nr.9, date 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ”, VKM nr.835, datë 03.12.2004 “ Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”VKM nr.965, datë 2.12.2015 “ Për bashkëpunimin ndër-institucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave ” e shfuqizuar nga VKM nr.923,datë 25.11.2020 VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “ Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndër-institucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”, Ligji nr.107/2016 “ Për prefektin e qarkut ”, VKM nr.147, datë 18.3.2004 “ Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave ” Udhëzimi i përbashkët i gjashtë ministrive nr. 248, datë 28.01.2000 “ Për hartimin e planit të alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digave dhe dambave ”, Urdhër i Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 116 datë 27.09.2004 “ Për kriteret dhe procedurat e komandës gjatë operimit në raste zjarresh dhe të incidenteve të ndryshme ”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin për Planin e Mbrojtjes Civile dhe Dokumentit për Vlerësimin e Rrishtut nga Fatkeqësitë Natyrore.
2. Miratimin e dokumentave bashkë-lidhur vendimit, si pjesë përbërëse e tij.

❖ **Plani i Mbrojtjes Civile.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

❖ Dokumenti i Vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë.

Si dy dokumentat kryesorë të institucionit të bashkisë për menaxhimin e emergjencave civile.

3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi sipas detyrave të përcaktuara në këta dy dokumenta ngarkohen institucionet dhe drejtoritë në territorin e Bashkisë Kamëz.
4. Ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile & Strehimit për përditësimin e herë pas hershëm të të dhënave sipas ndryshimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli  
Hysen Koldashi

